



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 389, datë 22.09.2021**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN**  
**NË DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR**  
**KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONET E**  
**LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 223, DATË 02.07.2020 DHE**  
**NR. 125, DATË 01.04.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, bazuar në rezultatet e shortit për zgjedhjen e relatorit,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 223, datë 02.07.2020 dhe nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Alban Toro, si relator të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**